

*Preserving*TIRANA

JORA KASAPI

Abstrakt

Arkitektura dhe planifikimi urban i një qyteti janë projeksion i shoqërisë, i ndryshimeve politike dhe lëvizjes së pushtetit që ndodhin në të, një premisë që i përshtatet veçanërisht Tiranës. Struktura e saj urbane është formuar nga një proces i vazhdueshëm “tabula rasa”, duke vazhduar edhe më intensivisht sot, përmes zhvlerësimit të së kaluarës për ta zëvendësuar atë me “të rene”, hipotetikisht “bashkëkohoren”.¹ Kjo ka çuar në krijimin e një grupi specifik të veprave arkitektonike, të cilat janë përfaqësueset kryesore të mbijetuara të zhvillimit “organik” të Tiranës, si të ngecura në “limbo”, dhe të perceptimit si “ndërtesa të padëshiruara”. Kjo gjendje vjen si rezultat i mungesës së formave të ndryshme të ruajtjes arkitektonike, pavarësisht vlerave të pasura historike, kulturore dhe arkitektonike të ndërtesave në fjalë.

Duke qenë veçanërisht të prekshme dhe të rrezikuara, mënyra e gjetur për t’i ruajtur këto ndërtesa, në një situatë ku, për

¹ Albana Rexhepaj, *Përpyjekja* (Shqiptarët dhe arkitektura), nr. 34-35, Tiranë: Qendra “Përpyjekja”, 2015-16.

ta bërë këtë, vullneti institucional duket se mungon, ishte duke rivendosur ato dhe vlerat që ato përfaqësojnë në vëmendjen e komunitetit, duke aktivizuar përsëri memorien kolektive të komunitetit për to dhe, rrjedhimisht, për qytetin, duke ripërvetësuar kështu qytetin përmes rivlerësimit të tyre. Mjeti i përdorur është një platformë interaktive e dokumentimit digjital *preservingtirana.city*, ku e gjithë baza e të dhënave u krijua si një kombinim i kërkimit teorik me intervista etnografike të komunitetit, hartëzim i punës në terren dhe fotografim. Ajo përfaqëson një faqe bashkëpunuese dhe, në të njëjtën kohë, një platformë arkivimi publik, përmes përdorimit të dijeve të hapura (*open access*), platformave me kod-burim të hapur (*open source*) dhe licencave të hapura kreative (*Creative Commons licences*) për përmbajtjen e saj. Meqenëse këto ndërtesa janë pasuri e përbashkët për qytetin, marrja e njohurive rreth tyre dhe pasurimi i kësaj baze të dhënash vjen si një e drejtë dhe përgjegjësi e përbashkët. Prandaj, ky proces i arkivimit të shtresëzimit të historisë në hapësirë, në Tiranë është konceptuar si një proces i vazhdueshëm në kohë, pjesëmarrës dhe i qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: preservingTirana, arkitektura, komunitet, dokumentim digjital

Preserving Tirana ka lindur si projekt nga ndikimi i disa ngacmimeve dhe katalizatorëve të jashtëm, ku kryesorja, dhe më e rëndësishmja, ka qenë situata ekzistuese urbane në qytetin e Tiranës. Qyteti mjaft kompleks i Tiranës që njohim dhe që jetojmë sot nuk është realisht ndër qytetet më të hershme në Shqipëri, por ka një rrugëtim shumë të pasur shtresëzimi historik në kohë, i cili pasqyrohet qartazi edhe në arkitekturën e pëlhurën e saj urbane.

Viti 1614 shënon krijimin e bërthamës së parë urbane në Tiranë rrotull Xhamisë së Sulejman Pashës, Hamamit, një furre buke si dhe Tyrbesë së Kapllan Pashës. Fillimisht është zhvilluar si një qytet shumë organik gjatë periudhës otomane, pastaj, gradualisht, ka kaluar në një prej periudhave më të pasura nga pikëpamja e zhvillimit arkitektonik dhe planifikimit urban, gjatë protektoratit italian dhe pushtimit fashist (1925-1944). Nga vitet 1945-1990, gjatë diktaturës komuniste, është dominuar nga një arkitekturë e huazuar nga Bashkimi Sovjetik, si dhe arkitektura e realizmit socialist shqiptar.² Periudha e pas viteve '90, si periudhë tranzitore, nga pikëpamja arkitektonike karakterizohet nga një zhvillim kaotik e i pakontrolluar urban. Është shumë e rëndësishme që, për hir të ruajtjes së kësaj vazhdimësie në kohë të materializuar, ndër të tjera, dhe përmes arkitekturës, të evidentohen dhe ruhen ndërtesat kryesore të rëndësishme të këtyre periudhave. Për shkak të mungesës së proceseve të ndryshme të ruajtjes së tyre, si përmes restaurimit, konservimit etj, këto vepra arkitektonike qëndrojnë sot në një gjendje “in limbo” pavarësisht vlerës së tyre të pasur arkitektonike, kulturore, historike për qytetin, duke bërë kështu që të pagëzohen ironikisht me termin “ndërtesa të padëshiruara” të Tiranës. Thjesht ekzistenca e tyre shërbeu si katalizatori i parë për këtë projekt.

Pjesëmarrja në punëtorinë e karakterit kërkimor mbi urbanen nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit krijoi terrenin pjellor për shtjellimin më tej të kësaj ideje. Për më tepër, ekspozimi ndaj një libri nga antropologia holandeze, Melanie Van der Hort, *Indispensable Eyesores: An Anthropology of Undesired Buildings (Shëmtira të domosdoshme: Një antropologji e ndërtesave të padëshiruara)* më bëri ta shikoj

² Ermir Hoxha, *Arkitektura shqiptare e shek. XX*, Tiranë: West Print, 2015.

problematikën në një shkallë pak më të gjerë nga pikëpamja e zhvillimit të saj gjeografik dhe të shtrirjes në kohë. Filllova të mendoj mbi koncepte, si vlera e një vepre arkitektonike, pushteti i vënies së vlerës, vlerë e cila mund të ndryshojë në varësi të grupit të interesit që e atribuon atë. Trajtimi i problematikës së arkitekturës së braktisur e të padëshiruar në kontekstin e vendeve post-komuniste të Evropës Lindore më ngacmoi kuriozitetin për ta bërë këtë ushtrim studimor në kontekstin e Tiranës dhe të kësaj tipologjie që, qartazi, për mua, po evidentohet dhe bëhet më e dukshme, më alarmante. Van der Horn flet për një koncept shumë interesant të ekzistencës së një boshti hipotetik të vlerësimit të veprave arkitektonike, që përbëhet nga dy ekstremet me ndërtesa me vlerë pozitive dhe negative, ndërtesa me vlerë “0”, ndaj të cilave komuniteti është indiferent, si dhe një zonë vlerash, e tëra gri, me një mori ndërtesash të përfshira aty. Ndërtesat pozitive përfaqësoheshin nga ndërtesa të vlerësuara nga pikëpamja institucionale, të listuara si asete trashëgimie, ndërtesa që përfshihen në libra arkitekture, ndërtesa që bëhen pjesë e guidave turistike etj. Ndërtesat e ankoruara në boshtin negativ të vlerave janë ato që kanë marrë një konotacion negativ nga evente të errëta historike në periudha të caktuara.³ Fillon të kuptosh se si vlera që i jepet një ndërtesë varet nga grupi i interesit që ia atribuon këtë vlerë si dhe varion edhe në kohë. Së pari, e njëjta ndërtesë merr vlera të ndryshme në këtë bosht hipotetik nga komuniteti dhe nga strukturat politikëbërëse dhe entitetet vendimmarrëse. Po ashtu, e njëjta ndërtesë në periudha të ndryshme historike dhe kohore merr vlera të ndryshme, duke lëvizur nga vlerat negative në pozitive në

³ Melanie Van Der Horn, *Indispensable Eyesores: An Anthropology of Undesired Buildings*, New York dhe Oxford: Berghahn Books, 2009.

bosht dhe anasjelltas. Ka plot shembuj të tillë në Tiranë: rasti i ndërtesës së Piramidës, i të ashtuquajturit “Pallati me kuba” i Maks Velos, apo rasti më i ndjeshëm, duke qenë dhe më aktual, i Kompleksit “Skënderbej” me Teatrin Kombëtar “të martirizuar” rishtazi. Ndërtesa të tilla, që kanë një cikël kaq të pasur jetësor dhe janë dëshmitare të ndryshimeve më të rëndësishme historike, politike, sociale të një vendi, duhet të evidentohen e të ruhen me çdo formë.

PreservingTirana, më saktë, *preservingtirana.city* u mendua si një platformë ndërvepruese, një dokumentim digjital, ku e gjithë databaza është krijuar nga kombinimi i hulumtimit teorik arkitektonik, intervistave me komunitetin lokal në afërsi të këtyre ndërtesave, evidentimit përmes hartëzimit në terren të tyre, përmes vendndodhjes gjeografike si dhe fotografimit. Kjo platformë bën ruajtjen e kësaj kategorie vulnerabël dhe të rrezikuar ndërtesash me vlerë, në një situatë ku mungon vullneti institucional për ta bërë këtë, dhe përfaqëson, në të njëjtën kohë, një formë arkivimi të shtresëzimit historik të Tiranës në kohë. (Fig. 1)

Kjo ndërfaqe siguron një informacion të përmbledhur, më të strukturuar mbi arkitekturën e qytetit dhe, më e rëndësishmja, e gjitha në domain publik. Ky tipar e bën më të lehtë, më të aksesueshëm një informacion që shpesh nuk është shumë i lehtë për t’u gjendur, në qoftë se nuk je pjesë e rrethëve të caktuara profesionale apo nuk ke akses në një literaturë specifike të lidhur më shumë me arkitekturën dhe urbanistikën. Padyshim këtu shtohen edhe vështirësitë procedurale, burokratike që hasen në aksesimin e informacionit nga institucionet shtetërore, mbartëse të një materiali të tillë, në Tiranë.

Ishte i rëndësishëm krijimi i një procesi më demokratik të përfshirjes së komunitetit, kthimin e tyre në pjesëmarrës aktivë në procesin e realizimit të projektit. Duke qenë këto ndërtesa asete të përbashkëta për qytetin, marrja e njohurive mbi to, dhe, anasjelltas, pasurimi i databazës, vjen si një e drejtë dhe përgjegjësi e përbashkët. Duke qenë se Shqipëria ka kaluar nëpër disa etapa historike, gjatë së cilave, në një mënyrë apo në një tjetër, është abuzuar me konceptin e “së përbashkëtës”, sidomos gjatë diktaturës komuniste, por edhe në demokraci, sot, një qasje pro-aktive për ruajtjen e kësaj “të përbashkëte” identitare, arkitektonike, hapësinore dhe materiale, paraqitet pak e turbullt dhe e vështirë.

Aktualisht jemi dëshmitarë të përshpejtimit të ritmit të shembjeve të këtyre ndërtesave dhe në një skenar aspak optimist të së ardhmes ky tjetërsim i qytetit përmes shkatërrimit, duket si i pashmangshëm. Për pasojë, ajo çfarë ky projekt ka në dorë është që të ruajë të paktën një pjesë të mirë të gjurmëve të asaj Tirane autentike që ka ekzistuar. Ajo, në këtë situatë, ngjason gjithnjë e më shumë me një nga qytetet e Italo Calvinos në *Qytetet e padukshme (Le città invisibili)*, me Maurilian:

“...Kujdesuni mos u thoni atyre se nganjëherë qytete të ndryshme pasojnë njëri-tjetrin mbi të njëjtin vend pa u njohur me njëri-tjetrin, të pakomunikueshëm mes tyre. Ka raste që dhe emrat e banorëve mbetën të pandryshuar, nga theksi i zërave e deri dhe tiparet e fytyrave; por perënditë që banojnë poshtë emrave e sipër vendeve kanë ikur pa thënë asgjë e vendin e tyre e kanë zënë perëndi të huaja. Është e kotë të pyesësh në janë ato më të mira apo më të këqija se të vjetrat, derisa mes tyre nuk ka asnjë lidhje, ashtu sikurse dhe kartolinat e vjetra nuk e

paraqesin Maurilian sikundër ishte, por një qytet tjetër që rastësisht quhej po si ky, Maurilia.”⁴

Mjetet e përdorura për këtë lloj dokumentimi

Synimi fillestar i projektit ishte që të jetë shumëdisiplinor, pra një përpjekje për të kombinuar arkitekturën me kulturën *open source*. Ishte e rëndësishme që dhe platformat e përdorura për strukturën e ndërfaqes të ishin me kod-burim të hapur dhe përfaqësuese të dijës TECH etike. Si fillim, e gjithë struktura dhe informacionet e saj janë nën një licencë kreative të hapur, *Creative Commons ShareAlike 4.0*, ku praktikisht gjithçka në përmbajtje të ndërfaqes mund të aksesohet, përdoret për qëllime fitimi ose jo, për aq kohë sa citohet burimi nga është marrë materiali. Gjithçka është e dokumentuar dhe ndodhet në një platformë që quhet *GITHUB* dhe që përdoret masivisht nga zhvillues *software*-sh dhe jo vetëm për të organizuar punën në grup. Gjithkush ka mundësinë, me ca dije pak më teknike, ta marrë strukturën e ndërfaqes në fjalë dhe ta përmirësojë, replikojë etj, për të siguruar p.sh., një faqe të ngjashme për një qytet tjetër me po këtë problematikë.

Platforma të tjera të përdorura janë: *Open Street Map*, për pozicionimin e vendndodhjes së ndërtesave në një hartë të krijuar si një kontribut i përbashkët nga vullnetarë të vendeve të ndryshme, si pjesë e rëndësishme e dijës së hapur; për arkivimin e të gjithë materialit fotografik është përdorur platforma *Wikimedia Commons*, platforma analoge e Wikipedia-s, por e destinuar për materiale fotografike, video, audio, përmes kontributit të miliona

⁴ Italo Calvino, *Le città invisibili*, New York: Harcourt Brace Jovanovich, 1974, ff. 30-1.

vullnetarëve. Puna përmes përdorimit të kësaj platforme siguron një kontribut të dyfishtë për projektin si dhe për Wikimedia-n vetë si pjesë e pasurimit të databazës grafike mbi arkitekturën e Shqipërisë në këtë platformë.

Për sa i përket metodologjisë së punës është zgjedhur një metodë e ndërthurur, duke alternuar kërkimin teorik, përmes literaturës, me hulumtimin në terren. Fillonte nga ndërtesat e evidentuara përmes literaturës mbi arkitekturën dhe historinë e Tiranës dhe më pas ato hartëzoheshin duke i lokalizuar në terren. Ndodhte dhe e anasjella: nga vizitat në terren evidentoheshin tipologji arkitektonike të veçanta, për të cilat kërkohim më tej informacione historike përshkrimore, duke intervistuar komunitetin vendas e, më tej, duke kërkuar në nivel literature.

Duke qenë një projekt që kombinon disa disiplina dhe kërkon, në të njëjtën kohë, të angazhojë individë me ekspertiza të ndryshme në vazhdim për mirëmbajtjen e tij, organizimi i një platforme të strukturuar, që të lejonte përfshirjen e gjithsecilit, ka qenë sfida e parë në nivel planifikimi dhe idejimi. Bashkëpunimi është njëri nga elementet që eksperienca ka treguar, garanton një punë më kreative, por, në të njëjtën kohë, edhe më sprovuese. (Fig. 2)

Janë hasur shumë vështirësi gjatë punës, sidomos gjatë intervistave në terren. Ka qenë shpesh e vështirë të orientosh bisedën në pikat me interes për projektin dhe më relevante për të. Shpeshherë kemi hasur një skepticizëm dhe mungesë gatishmërie për të ndarë informacione, sidomos në rastin e pronarëve të banesave, të cilët shpesh na ngatërronin me përfaqësues të strukturave shtetërore apo lokale vendimmarrëse, si, në rastin konkret, me banesën e “Sarajeve të Toptanëve”. Një pjesë e këtyre ndërtesave kanë qenë të braktisura, me bashkëpronarët e tyre

originalë të ndodhur jashtë vendit, gjë që i bënte ato më të paaksesueshme, po ashtu edhe informatat për to. Në raste të tjera më specifike, këto ndërtesa të braktisura e në prag degradimi janë zënë nga njerëz të pastrehë, të cilët në çdo tentativë tonën për të komunikuar me ta mbi ndërtesën na kanë parë me dyshim dhe si faktor që mund të rrezikonte qëndrimin e tyre në këto ndërtesa, si në rastin e vilës së ish Radio-Tiranës.

Vështirësi tjetër ka qenë dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për të përdorur platformat *open source* në dhënien e kontributit të tyre për pasurimin e plotësimin më tej të ndërfaqes. Për këtë kemi realizuar një seri punëtorish dhe aktivitete në formën e shëtitjeve arkitektonike në qytet për të nxitur ndërgjegjësimin për kauzën si dhe aftësimin e njerëzve të interesuar në përdorimin e këtyre mjeteve, mbase jo të zakonata, në këtë proces arkitekture të pjesëmarrjes.

Në Shqipëri, praktika e vlerësimit institucional të veprave arkitektonike, pra listimit të tyre si monumente të trashëgimisë kulturore, është relativisht e vonë. Që nga themelimi i Institutit të Monumenteve në vitet '60, e deri më sot, nuk ka akoma një vlerësim të mirëfilltë të ndërtesave moderniste shqiptare në rastin më të thjeshtë, gjë që i bën ato pre të degradimit dhe legjitimon çdo ndërhyrje arbitrare tjetërsuese.

Situata, në të cilën projekti është ngjizur, ishte shumë e qartë që do të kishte një dimension politik. Nuk mund të ishte thjesht një dokumentim informues arkitektonik, veçanërisht për tipologjinë që dokumenton. Konteksti urban, që ishte dhe rrjedhojë e një konteksti politik, kërkonte një formë reagimi, një formë rezistence dhe, duke qenë se gjithsecili zgjedh ta bëjë rezistencën përmes mënyrave dhe mjeteve që njeh më mirë, për ne, forma më natyrale që lidhej dhe me profilin tonë profesional, ishte kjo

platformë gjithëpërfshirëse arkitektonike. Ajo çfarë kemi vënë re, ka qenë një ndërgjegjësim mbi kauzën e këtyre “ndërtesave të padëshiruara” nga komuniteti, një ndërgjegjësim i shtuar nga reagimet në kanalet tona të komunikimit si dhe nga kontributet e tyre të konsiderueshme në platformë.

Përmes kërkimit për *preservingtirana.city* u kuptua që, në një masë të madhe, tipologjia më e rrezikuar, braktisur dhe e lënë në kursin e natyrës ishte tipologjia e banesës. Si rrjedhojë, me këtë përfundim u mendua të ideohet një platformë e ngjashme për dokumentimin e kësaj tipologjie arkitektonike në një territor më të shtrirë gjeografik, përgjatë gjithë Shqipërisë, duke përfshirë banesën e fshatit si dhe të qytetit, nga veriu në jug. (Fig. 3) Platforma u pagëzua me emrin *thealbanian.house* dhe përbën, gjithashtu, një ndërfaqe interaktive që kombinon përdorimin e platformave *open source* me arkitekturën e pjesëmarrjes dhe arkivon banesën shqiptare si një ndër tipologjitë më të rëndësishme që dëshmon edhe nivelin e zhvillimit social, kulturor dhe ekonomik të vendit përgjatë periudhave të ndryshme, duke qenë e lidhur më ngushtë me jetesën dhe përditshmërinë. (Fig. 4)

Gradualisht, tema e “së padëshiruarës”, e “braktisjes”, e “cenueshmërisë” u bë një lejtmotiv i rëndësishëm përtej kufirit të Shqipërisë, duke e prekur këtë problematikë dhe në kontekstin urban, tashmë të Prishtinës, me të gjithë problematikat e tjera specifike të këtij qyteti, të krijuara nga zhvillimi i tij historik dhe politik. Projekti që e pasoi ishte *preservingpristina.city*, nën strehën e *preservingwb.city*, platformë për rajonin, ku *preservingtirana.city* u bë projekti pilot pikënisje për këtë të fundit. (Fig. 5) Vazhdimësia organike e projekteve dëshmoi për një nevojë të kësaj forme dokumentimi dhe tregoi dhe se sa të afërt jemi në nivel zhvillimi arkitektonik e urban në rajon.

Në përfundim, kjo formë dokumentimi është e rëndësishme, sepse ri-sjellja e kësaj arkitekture dhe vlerave që ajo përfaqëson në vëmendjen e komunitetit e mbron atë nga harresa, përfaqëson hapin e parë dhe shumë të rëndësishëm për ruajtjen e tyre. Kjo mënyrë dokumentimi krijon kushtet dhe mundësitë për të hapur shtigje të reja diskursive mbi atë se si kjo e shkuar mund të përdoret në skenarë të mundshëm të së ardhmes. Skenarët e mundshëm të së ardhmes, që unë shikoj për këto ndërtesa, kanë të bëjnë, së pari, me rivlerësimin e tyre, ripagëzimin e tyre, jo vetëm si “ndërtesa të dëshiruara”, por edhe thelbësore për identitetin e qytetit, përmes ripërdorimit dhe rijetëzimit të tyre me ide inovative. Siç thekson dhe aktivistja, gazetarja Jane Jacobs në *The Death and Life of Great American Cities* (*Vdekja dhe jeta e qyteteve të mëdhaja amerikane*): “Idetë e vjetra shpesh përdorin ndërtesa të reja, por idetë e reja duhet të përdorin ndërtesat e vjetra.”⁵

⁵ Jane Jacobs, *The Death and Life of Great American Cities*, New York: Modern Library, 2011.



Fig. 1. Përmbledhje e disa prej ndërtesave të hartëzuara në platformë.
Riprodhuar me lejen e *preservingtirana.city*.




Fig. 2. Puna shumëdisiplinore për platformën dhe ndërgjegjësimi publik.
Riprodhuar me lejen e *preservingtirana.city*.




Fig. 5. Struktura e platformës *preservingwb.city*. Riprodhuar me lejen e *preservingwb.city*.